



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË NË  
INFRASTRUKTURË DHE ENERGJI  
DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE  
ASISTENCËS

**Njoftim publik**

**Lidhur me ngritjen e Tryezave të Diskutimit dhe Këshillimit në kuadër të procesit të  
Integrimit Evropian**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për Integrimin Evropian”; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e institucionit drejtues për kapitujt e mëposhtëm:

- Kapitulli 10 “Shoqëria e informacionit dhe media”
- Kapitulli 14 “Politika e transportit”
- Kapitulli 15 “Energjia”
- Kapitulli 21 “Rrjetet transevropiane”

fton përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të medias dhe të grupeve të interesit, referuar përcaktimeve të kreut III. 2, pika 4 të Urdhrit të Kryeministrit të marrin pjesë lirisht në Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit në kuadër të procesit të Integrimit Evropian.

Sipas përcaktimeve të kreut III. 2 të Urdhrit të Kryeministrit, aplikimi për t’u bërë pjesë e tryezave të diskutimit dhe këshillimit kryhet nëpërmjet dorëzimit të një *letre interesi*, si dhe *CV të personit apo të grupimit që përfaqëson*, duke treguar se kanë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezat specifike.

Personat apo përfaqësuesit e grupeve të interesit mund të paraqesin dokumentacionin e sipërcituar për pjesëmarrje brenda datës 10 Nëntor 2019 në adresat e mëposhtme elektronike të sekretariateve teknike të GNPIE-eve, sipas Kapitujve:

- Kapitulli 10 “Shoqëria e informacionit dhe media”
  - [Enkelejda.Malaj@infrastruktura.gov.al](mailto:Enkelejda.Malaj@infrastruktura.gov.al)
  - [Zana.Joca@infrastruktura.gov.al](mailto:Zana.Joca@infrastruktura.gov.al)
- Kapitulli 14 “Politika e Transportit”
  - [Zana.Joca@infrastruktura.gov.al](mailto:Zana.Joca@infrastruktura.gov.al)
  - [Enkelejda.Malaj@infrastruktura.gov.al](mailto:Enkelejda.Malaj@infrastruktura.gov.al)

– Kapitulli 15 “Energjia”

- [Enkelejda.Malaj@infrastruktura.gov.al](mailto:Enkelejda.Malaj@infrastruktura.gov.al)
- [Leandro.Xhama@infrastruktura.gov.al](mailto:Leandro.Xhama@infrastruktura.gov.al)

– Kapitulli 21 “Rrjetet transevropiane”

- [Zana.Joca@infrastruktura.gov.al](mailto:Zana.Joca@infrastruktura.gov.al)
- [Leandro.Xhama@infrastruktura.gov.al](mailto:Leandro.Xhama@infrastruktura.gov.al)